

## *Gëzuar Krishtlindjen dhe një Vit të Ri të bekuar!!!*

26. Martesat që kanë nevojë për dashurinë e Perëndisë. “Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (Efesianëve 4: 31-32).

27. Gratë e krishtera të dinë se trupat e tyre janë vendbanimet e Perëndisë, Shpirtit të Shenjtë dhe se ato duhet të kujdesen e të nderojnë Perëndinë me trupat e tyre. “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?” (1 Korintasve 3:16).

28. Gratë që të jenë të gatshme të ndryshojnë prioritetet, oraret, marrëdhëniet dhe çdo gjë tjetër që i pengon ato të ndjekin vullnetin e Perëndisë. “O Zot, më trego rrugët e tua, më mëso shtigjet e tua. Më udhëhiq në të vërtetën tënde dhe më mëso, sepse ti je Perëndia i shpëtimit tim; unë shpresoj shumë te ti gjatë gjithë ditës.” (Psalmi 25: 4-5).

29. Njerëzit që të flasin kur shohin fëmijë në rrezik ose vërejnë burra të çuditshëm që i shikojnë fëmijët, mbase duke planifikuar t'i rrëmbejnë. Trafikantët e qenieve njerëzore dhe molestatorët po i marrin me guxim fëmijët që presin për autobusët e shkollës, duke luajtur në oborr apo kur janë duke bërë pazar .

30. Prindërit për t'u kujdesur për vajzat e tyre adoleshente dhe për t'i mbrojtur ato nga marrëdhëniet që do t'i dëmtojnë, duke i mësuar ato që të respektojnë veten dhe të planifikojnë një të ardhme të shëndetshme.

31. Gratë të dinë se ato janë krijuar nga një Perëndi i dashur që dëshiron të mbushë jetët e tyre me shpresë. “Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.” (Zanafilla 1:27).

Dhjetori është një muaj i veçantë për të krishterët ndërsa përgatitemi për të festuar dhe për t'i shpallur botës dhuratën më të mirë ndër të gjitha dhuratat: Perëndia që vjen në tokë si një fëmijë për të jetuar mes nesh. Gjatë Krishtlindjes nuk na pëlqen të ndalemi tek gjërat negative, por edhe pse Jezusi erdhi për të na shpëtuar nga mëkatet tona, Ai nuk do t'i japë fund dhembjes derisa të hyjmë në qiell. Dhe këto dhimbje përjetohen edhe nga gratë në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat nuk janë imune ndaj disa çështjeve të njëjta me të cilat përballen femrat në të gjithë botën: martesat e hershme, divorci, dhuna në familje, trafikimi njerëzor, përdhunimi dhe të tjera. Ato, gjithashtu, kanë nevojë për shpresën dhe shërimin e Jezusit.


Edhe kur moshja e martesës ligjore në të dy vendet është 18, përjashtimet lejohen me pëlqimin e një prindi ose gjyqtari. Shumë shpesh vajzat detyrohen të martohen me njerëz të moshuar për të shmangur turpin e familjes dhe kjo mund të çojë në mbulimin e abuzimit seksual.

Vajzat që ikin nga shtëpia ose janë në sistemin e kujdestarisë shpesh bëhen viktima të trafikimit seksual. Kërkimi për miq, ushqim dhe strehim i bën ato të pambrojtura ndaj atyre që ofrojnë alkool dhe droga për t'i ndihmuar ato të harrojnë dhimbjen e tyre. Trafikantët, që shpesh afrohen si kandidatë për të dashur, joshin vajzat deri në moshën 13 vjeç dhe i mbajnë ato në nënshtrim duke i tulatur dhe duke i bërë të besojnë se askush nuk do të kujdeset kurrë për to.

Dhjetëra miliona emigrantë janë në Kanada dhe në SHBA duke kërkuar një jetë më të mirë. Shumë prej tyre bëhen viktima të trafikimit njerëzor. Gratë nga Kina, Koreja e Jugut apo Tajlanda shpesh shfrytëohen në sallat e masazhit dhe salonet e thonjve. Disa janë emigrante të ligjshme me viza pune, por ato kërcënohen nga trafikantët e tyre me dëbimin nga vendi, të cilët ua mbajnë të ardhurat dhe kontrollojnë jetën e tyre.

Bashkohuni me ne në lutjet për gratë në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara për të gjetur shpresë nëpërmjet Jezusit.

## Të lutemi për gratë në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara



Dëgjoni kalendarin e lutjes online në [twr-albania.com](http://twr-albania.com)

Dëgjoni programin “Shpresë për ty” në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe

17:00

1. Ndhimë nga Perëndia dhe Mbreti ynë që të mbrojmë të pikëlluarit, të tregojmë mëshirë për të dobëtit dhe nevojtarët dhe të ndihmojmë në çlirimin e të shtypurve. (Psalmi 72: 4)

2. Gratë emigrante që jetojnë në Kanada ose në SHBA për të dëgjuar për Krishtin dhe duan të dinë për Perëndinë. Lutuni që individë të mund të takohen me to dhe t'u mësojnë atyre për Jezusin.

3. Gratë dhe vajzat që manipulohen nga ata që e qasin veten të gatshëm për të qenë të dashurit e tyre dhe futen pastaj në skllavërinë seksuale. Lutuni që ato të jenë në gjendje të shpëtojnë dhe të gjejnë lirinë e vërtetë dhe shërimin në Krishtin.

4. Gratë që kërkojnë vlerën e tyre në marrëdhënie, në mëmësinë, suksesin financiar ose gjëra materiale për të zbuluar se vlera e tyre e vërtetë është në Krishtin. "Por të gjithë atyre që e pranuan atë, atyre që besuan në emrin e tij, ai u dha të drejtën të bëheshin bij të Perëndisë" (Gjoni 1:12).

5. Udhëheqësit e Kanadasë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të vazhdojnë ta bëjnë përparësi të madhe dhënies fund të trafikimit njerëzor. Backpage.com, portali më i madh i trafikut të njerëzve në SHBA, u mbyll nga FBI në prill.

6. Vajzat që janë të detyruara në martesë, por nuk kanë të drejtat e një të rrituri, duke i penguar ato që të jenë në gjendje të qëndrojnë në një strehë përkujdesjeje, të depozitojnë një urdhër mbrojtës apo një dokument për divorc. Lutuni që ligjet përkatëse të përmirësohen në favor të këtyre vajzave.

7. Kishat që të arrijnë tek gratë që përjetojnë dhunën në familje, duke i lënë ato të kuptojnë se ato kanë një vend të sigurt me familjen e Perëndisë.

8. Ndhimë dhe siguri për gratë vendase kanadeze dhe vajzat që janë në rrezik. Shumë janë vrarë ose zhdukur. Lutuni që qeveritë të gjejnë dhe të dënojnë autorët e dhunës kundër grave vendase (indigjene)

9. Të krishterët që të bëjnë më shumë për të mbrojtur gratë dhe bebet nga rezultatet shkatërruese të abortit. Lutuni për ato qindra nëna që zgjedhin jetën për foshnjat e tyre kur ju ofrua ndihmë dhe lutje para klinikave të abortit.

10. Të krishterët kanadezë të shoqërohen me ata që nuk janë vendas por kanë lindur atje (rreth 22 për qind e popullsisë) dhe të ndihmojnë emigrantët e rinj (rreth 60 për qind nga Azia, veçanërisht Kina dhe India) për t'u vendosur në komunitetet e tyre.

11. Të krishterët të miqësohen me më shumë se 40 milionë njerëz që jetojnë në Shtetet e Bashkuara të lindur në një vend tjetër; duke u kujdesur për ta, duke mësuar për betejat e tyre dhe duke ofruar ndihmë. "Për ta Perëndia ka zgjedhur të bëjë të njohur mes johebrenjve pasuritë e lavdishme të këtij misteri, që është Krishti në ju, shpresa e lavdisë" (Kolosianëve 1:27).

12. Të krishterët që të bëhen avokatë për fëmijët në kujdestari dhe të hapin shtëpitë e tyre për një pjesë nga 400,000 fëmijët që kanë nevojë për një vend të sigurt për të jetuar.

13. Gratë që kujdesen për mijëra foshnja të lindura nga droga për shkak të krizës opioidike në SHBA. Lutuni që të krishterët do t'i mbështesin këto gra me oferta për t'i ndihmuar me punët e shtëpisë ose për të blerë sendet e nevojshme.

14. Miliona gra që do të konsiderojnë abortet pasi besojnë se nuk kanë zgjedhje tjetër për shkak të presionit të prindërve, burrave, të dashurve, të tutorëve dhe këshilltarëve të karrierës. Lutuni që ato të zgjedhin jetën për foshnjat e tyre.

15. Gratë që të respektojnë veten, të marrin vendime të mençura dhe të kenë guximin të këmbëngulin në një përkushtim martesor dhe jo të bashkëjetojnë me burrat që ato duan.

16. Njerëzit në Kanada dhe në SHBA për të kuptuar se njerëzit që përdorin drogë ilegalisht, qoftë për argëtim apo për shkak se janë të varur, janë tërthorazi duke mbështetur vrasësit e bandave, dhunën gjinore, zhvatjen dhe sulmet terroriste.

17. Të krishterët që të ofrojnë dashuri, shpresë dhe miqësi grave dhe burrave që vazhdojnë të pikëllohen pas aborteve që sollën vrasjen e foshnjave të tyre. Shumë nga ata që vuajnë, kanë nevojë për dikë që t'i dëgjojë dhe të kujdeset për ta.

18. Gratë refugjate në Kanada dhe SHBA, të cilat jetojnë në izolim dhe frikë. Lutuni që ato të zhvillojnë miqësi të shëndetshme dhe të marrin ndihmë për t'u përballur me traumën që kanë përjetuar.

19. Të krishterë që të mbështesin qendrat lokale të shtatëzaniqë që ofrojnë sonogramet falas, rrobat e foshnjave dhe sende të tjera që ka nevojë një nënë e re.

20. Gratë që përballen me kërcënimet me vdekje ndaj vetes, fëmijëve të tyre ose të afërmve nga burrat apo dashnorët që kërkojnë të ushtrojnë kontroll duke i izoluar nga miqtë dhe familja.

21. Shërimin e Perëndisë për mendjet dhe emocionet e fëmijëve që dëshmojnë abuzimin në familje, duke i bërë ata të prirur të vuajnë nga çrregullime psikiatrike dhe më shumë gjasa të rriten për t'u bërë viktimë apo abuzues.

22. Gratë e zëna në grackën e varfërisë, nga edukimi i pakët dhe nga mundësi jo të mëdha në komunitetet e tyre. Lutuni për njerëzit që i prezantojnë këto gra me shërbimet në dispozicion të tyre për të ndihmuar në përmirësimin e jetës së tyre.

23. Gratë dhe vajzat të cilave u është thënë se nuk janë gjë tjetër veçse plehra. Lutuni që ato të dëgjojnë të vërtetën: "Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që kushdo që beson në Të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme" (Gjoni 3:16).

24. Ato gra që jetojnë në situata në dukje të pashpresa që të gjejnë shpresë nëpërmjet Jezusit. Lutuni që ato të dëgjojnë për dhuratën e madhe të Perëndisë për shpëtimin nëpërmjet Jezu Krishtit. "Por engjëlli u tha atyre: "Mos druani, sepse unë po ju lajmëroj një gëzim të madh për të gjithë popullin; sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti." (Luka 2: 10-11).

25. Gratë e krishtera për të deklaruar se Jezusi është përmbushja e asaj që Perëndia foli me anë të profetit Isaia: "Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë, dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i venë emrin Emanuel, që do të thotë: Zoti me ne" (Mateu 1:23, Isaia 7:14)